

Ilira Aliu¹

UDC: 343.137.3(497.115)"1999/2022"

GJYKIMI NË MUNGESË NË KOSOVË**СУДЕЊЕ ВО ОТСУСТВО ВО КОСОВО****TRIAL IN ABSENTIA IN KOSOVO****Abstract**

In the contemporary world where we are dealing with democratic states in which the fundamental principles of law apply and in the spirit of further development of human rights, the issue of trial in absentia represents a specific and very important issue that challenges two main directions of criminal procedure. Trial in absentia is a tool available for the efficiency of the procedure while it is controversial in terms of the realization of the rights of the defendant in the procedure.

This scientific paper aims to address the trial in absentia in terms of time, specifically starting from 1999, as a time when Kosovo began its steps towards legislative independence and continues to address the course of Kosovo's legislation over the years, but to a greater extent focuses on the treatment of trial in absentia according to the Kosovo Criminal Procedure Code of 2022 with all the specifics contained in this code regarding this topic, because this issue constitutes one of the innovations brought by this Code and deserves adequate theoretical treatment to avoid problems in practical application. The time aspect of the treatment of this topic will help us understand the changes that have occurred and the progress achieved regarding trial in absentia and at the same time by addressing the legal provisions separately we will find out how applicable this type of trial will be in Kosovo.

1. Vështrim historik i gjykimit në mungesë në Kosovë pas vitit 1999

Kosova pas vitit 1999, me mbështetjen e UNMIK-ut dhe institucioneve të saj, filloi me zbatimin e legjislacionit i cili kishte përbërje nga Rregulloret e shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe

¹ Master of Criminal Law, University of Prishtina "Hasan Prishtina", str. "Agim Ramadani", 10000, Prishtina. Email: aliuilira@gmail.com

instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to dhe me ligjin në fuqi në Kosovë deri më 22 mars 1989, ndërsa në rast se një çështje nuk mbulohet nga korniza e lartcekur, mund të zbatohet edhe ligji i pas kësaj date nëse nuk ishte diskriminues.²

Në aspekt të procedurës penale, Kosova ka shfrytëzuar kryesisht Ligjin e Procedurës Penale të RSFJ-së të vitit 1977, me të cilin lejohej gjykimi në mungesë, ndërsa në vazhdim me Kodin e Procedurës Penale të vitit 2003, gjykimi në mungesë nuk ishte paraparë edhe më tutje si mundësi në kuadër të lëgjislacionit të ri. Njësoj, edhe Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës i vitit 2012 nuk kishte paraparë gjykimin në mungesë, por me ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale në vitin 2022, gjykimi në mungesë u rikthye, për të gjetur zbatim më tutje. Është mjaft interesante që në një periudhë kohore kaq të shkurtër, Kosova ka përjetuar ndryshime të mëdha të lëgjislacionit të saj, të cilat në shikim të parë mund të paraqesin jostabilitet dhe kornizë ligjore të papërshtatshme për tu zbatuar në praktikë.

2. Gjykimi në mungesë sipas Ligjit të Procedurës Penale të RSFJ-së të vitit 1977

Me Ligjin e Procedurës Penale të RSFJ-së, i cili hyri në fuqi më 1 korrik 1977, ishte paraparë gjykimi në mungesë, por megjithatë nuk ishte paraparë ndonjë rregullim specifik. Në nenin 300 par.3, të këtij ligji, në kuadër të prezumimeve për mbajtjen e seancës kryesore ishte paraparë se “I akuzuari mund të gjykohej në mungesë vetëm kur gjendet në arratisje, ose nuk është e mundur të shtihet në dorë nga organet shtetërore, e ekzistojnë shkaqe posaçërisht të rëndësishme që të gjykohej edhe se mungon”.³ Pra, përkundër faktit se prezenca e të akuzuarit në seancën kryesore është kusht për mbajtjen e saj, nën kushte të caktuara i akuzuari mund të gjykohej edhe në mungesë (gjykimi in kontumacion).⁴

Ky përkufizim si në nenin 300 par.3, është mjaft i gjerë, sepse nuk përcakton kriteret se kur ekzistojnë shkaqet “posaçërisht të rëndësishme” që të gjykohej i pandehuri edhe pse mungon, andaj rreziku i arbitraritetit të institucioneve gjyqësore ka qenë i mundur.

Megjithatë duhet përmendur se gjykimi në mungesë ka qenë i mundur të zhvillohet vetëm në bazë të propozimit të paditësit, prandaj ka qenë një e drejtë të cilën i njëjti ka mundur ta shfrytëzojë, por nuk ka qenë e domosdoshme. Në rastet e tilla gjykata ka qenë e obliguar që të caktojë mbrojtësin, në kuadër të mbrojtjes obligatore, posa të nxjerrë aktvendim për gjykimin në mungesë. Në rast të ankesës ndaj aktgjykimit të shkallës së parë, nuk ishte

² Rregullore nr.2000/59 e UNMIK, 27 tetor 2000.

³ Ligji i procedurës penale të RSFJ, 1977, neni 300, par. 3.

⁴ Sahiti E, E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 1988, f.179.

paraparë ndonjë privilegj për të gjykuarin në mungesë, por në kuadër të ligjit ishte paraparë mundësia për të paraqitur prova të reja së bashku me arsyet se përse këto prova nuk kanë mundur të paraqiten më parë, mundësi të cilën ka mundur ta shfrytëzojë posaçërisht i dënuari në mungesë.

Megjithatë vlen të përmendet se gjykata e shkallës së dytë ka pasur për obligim që në çdo rast, pa marrë parasysh se mbi cilën bazë është ankuar ankuesi, të shqyrtojë nëse seanca kryesore është mbajtur në mungesë të të akuzuarit, në kundërshtim me dispozitat ligjore. Ndërsa sa i përket procedurës për të mitur, ishte paraparë se në asnjë rast i mituri nuk mund të gjykohej në mungesë.

3. Sigurimi i pranisë së të pandehurit në seancën e shqyrtimit gjyqësor sipas Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës i vitit 2004

Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale solli ndryshime të mëdha në legjislacionin e vendit. Një nga këto ndryshime ishte se më tutje nuk parashihej fare mundësia e zhvillimit të gjykimit në mungesë. Përmes këtij ligji ishte paraparë se: “Kur i akuzuari i thirrur me rregull nuk paraqitet në shqyrtim gjyqësor dhe nuk e arsyeton mungesën, kryetari i trupit gjykues për të akuzuarin lëshon urdhërarrest në pajtim me nenin 270 të këtij Kodi. Kur i akuzuari nuk mund të sillet menjëherë, trupi gjykues e shtyn shqyrtimin gjyqësor dhe urdhëron që i akuzuari në seancën e ardhshme të sillet me forcë. Kur i akuzuari e arsyeton mungesën para arrestimit të tij, kryetari i trupit gjykues e revokon urdhërarrestin.”

“Kur shihet qartazi se i akuzuari i thirrur me rregull i shmanget paraqitjes së tij në shqyrtim gjyqësor dhe nuk ekzistojnë shkaqe për paraburgimin e tij nga neni 281 i këtij Kodi, trupi gjykues mund të caktojë paraburgim për sigurimin e pranisë së të akuzuarit në shqyrtimin gjyqësor. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit. Për paraburgimin i cili është caktuar për këto shkaqe, përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e neneve 279 deri te 297 të këtij Kodi. Po qe se paraburgimi i tillë nuk hiqet më parë, ai zgjat derisa të shpallet aktgjykimi, por jo më shumë se një muaj.”⁵

Përmes këtij neni ishte afirmuar rëndësia e pranisë së të pandehurit në shqyrtim gjyqësor, sepse synohej që në çdo rast të sigurohej prania e tij duke u munduar që në mënyrë minimale të cenohen të drejtat e të pandehurit, i cili edhe në rast kur qartazi mundahej t'i shmangej pjesëmarrjes në seancën e shqyrtimit gjyqësor, ishte paraparë mundësia e paraburgimit vetëm deri në 1 muaj.

Pra, meqenëse gjykimi në mungesë nuk ishte i lejuar, ishte paraparë paraburgimi i të pandehurit i cili qartazi i shmanget drejtësisë, duke mos u paraqitur edhe pasi është thirrur me rregull. Vlen të theksohet se një mundësi

⁵ Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale, 2004, neni 341, par.2.

e tillë ka ekzistuar edhe me Ligjin paraprak, i cili megjithatë kishte paraparë edhe gjykimin në mungesë për raste të nevojshme. Ndryshimet e tilla nuk ishin mirëpritur sa duhej nga shoqëria civile, sidoqoftë, ato vendosën një bazë e cila gjeti zbatim praktik dhe u ushtrua deri në vitin 2023.

4. Sigurimi i pranisë së të pandehurit në seancën e shqyrtimit gjyqësor sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të vitit 2012

Kodi i Procedurës Penale i vitit 2012 nuk solli ndryshime sa i përket gjykimit në mungesë, pra edhe më tutje nuk u përfshi mundësia e zhvillimit të seancës së shqyrtimit gjyqësor në mungesë të të pandehurit. Ky kod kishte paraparë se “Në shqyrtim gjyqësor thirret i akuzuari dhe mbrojtësi i tij, prokurori i shtetit, i dëmtuari dhe përfaqësuesit e tyre ligjor, përfaqësuesit e autorizuar si dhe përkthyesi. Dëshmitarët dhe ekspertët e propozuar nga prokurori i shtetit në aktakuzë dhe nga i akuzuari, sipas nenit 256 të këtij Kodi, thirren po ashtu në shqyrtimin gjyqësor.”⁶

“Kur i akuzuari i thirrur me rregull nuk paraqitet në shqyrtim gjyqësor dhe nuk e arsyeton mungesën, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues për të akuzuarin lëshon urdhërarrest në pajtim me nenin 175 të këtij Kodi. Kur i akuzuari nuk mund të sillet menjëherë, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues e shtyn shqyrtimin gjyqësor dhe urdhëron që i akuzuari në seancën e ardhshme të sillet me forcë. Kur i akuzuari e arsyeton mungesën para arrestimit të tij, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e revokon urdhërarrestin.”

“Kur shihet qartazi se i akuzuari i thirrur me rregull i shmanget paraqitjes së tij në shqyrtim gjyqësor dhe nuk ekzistojnë shkaqe për paraburgimin e tij nga neni 187 i këtij Kodi, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues mund të caktojë paraburgim për sigurimin e pranisë së të akuzuarit në shqyrtimin gjyqësor. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit. Për paraburgimin, i cili është caktuar për këto shkaqe, përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e neneve 185 deri 203 të këtij Kodi. Po qe se paraburgimi i tillë nuk hiqet më parë, ai zgjat derisa të shpallet aktgjykim, por jo më shumë se një (1) muaj.”⁷

Ky kod kishte paraparë se “Përfshirja e publikut nuk zbatohet për palët, të dëmtuarin, përfaqësuesit e tyre dhe mbrojtësin, përveç nën kushtet e dispozitave për mbrojtjen e të dëmtuarve, dëshmitarëve bashkëpunues ose të dëshmitarëve, siç parashihet në kapitullin XIII të këtij Kodi.”⁸ Ndërsa në nenin 302 ishte paraparë se “Kur i akuzuari, mbrojtësi, i dëmtuari, përfaqësuesi ligjor ose përfaqësuesi i autorizuar, dëshmitari, eksperti, përkthyesi ose personi tjetër që merr pjesë në shqyrtim gjyqësor prish rendin ose nuk u bindet

⁶ Kodi i Procedurës Penale (2012), neni 287, par. 1.

⁷ KPP (2012), neni 307, par. 1 dhe 2.

⁸ KPP (2012), neni 295, par. 1.

urdhrave të gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues për mbajtjen e rendit, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues ia tërheq vërejtjen.”

Kur vërejtja është e pasuksesshme, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të urdhërojë që i akuzuari të nxirret jashtë gjykatores, kurse personat tjerë jo vetëm që mund t’i nxjerrë jashtë, por mund t’i dënojë me gjobë deri në njëmijë (1.000) Euro. Me urdhër të gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues, i akuzuari mund të nxirret përkohësisht nga gjykatorja, por nëse ai është marrë në pyetje në shqyrtimin gjyqësor, atëherë mund të nxirret gjatë tërë kohës së shqyrtimit të provave.

“Para përfundimit të procedurës së provave, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues thërret të akuzuarin dhe e njofton për rrjedhën e shqyrtimit gjyqësor. Kur i akuzuari vazhdon të prishë rendin dhe të ofendojë dinjitetin e gjykatës, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues përsëri mund ta nxjerrë nga seanca. Në këtë rast, seanca përfundon pa praninë e të akuzuarit, kurse aktgjykimin ia komunikon gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues ose gjyqtari anëtar i trupit gjykues në praninë e procesmbajtësit.”⁹

Vërejmë se përmes këtij neni është e lejuar nxjerrja jashtë e të pandehurit përkohësisht apo gjatë gjithë kohës së shqyrtimit të provave. Edhe pse potencohet se i akuzuari mund të nxirret jashtë gjatë gjithë procedurës së provave, kjo nuk nënkupton se lejohet gjykimi në mungesë të të pandehurit, pasi në këtë rast vërejmë se kërkohet realizimi i kushtit që i pandehuri të jetë marrë në pyetje në shqyrtim gjyqësor.

Edhe sa i përket nxjerrjes jashtë gjykatores përkohësisht të të pandehurit të padisiplinuar, nuk kemi të bëjmë me ndonjë formë të gjykimit në mungesë, sepse në çdo rast para përfundimit të procedurës së provave, gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues kishte obligim që ta ftojë të akuzuarin për ta njoftuar me rrjedhën e procedurës dhe të pandehurit i jepej mundësia që të shpreh qëndrimet e veta lidhur me provat dhe me procedurën. Gjithsesi nxjerrja jashtë duhet të reduktohet në masën që është e domosdoshme për zhvillimin e procesit të të provuarit.¹⁰ Kjo kishte të bënte pikërisht me faktin e moslejimit të gjykimit në mungesë.

5. Gjykimi në mungesë sipas Kodit të Procedurës Penale të vitit 2022

Kodi i Procedurës Penale, i cili hyri në fuqi më 17 shkurt 2023, në kuadër të ndryshimeve të shumta ka paraparë edhe mundësinë e zhvillimit të gjykimit në mungesë. Fillimisht po sqarojmë mënyrën se si ky Kod ka paraparë thirrjen e të pandehurit në seancën e shqyrtimit gjyqësor.

⁹ KPP (2012), neni 302, par. 1 dhe 2.

¹⁰ Sahiti E, Murati R, Elshani Xh, Kodi i Procedurës Penale i Kosovës - Komentar, Prishtinë, 2014, f.767.

Në shqyrtim gjyqësor thirrjet e pandehuri dhe mbrojtësi i tij, ndërsa thirrja duhet t'i dërgohet të akuzuarit të paktën 8 ditë përpara datës kur është paraparë të mbahet seanca e shqyrtimit gjyqësor, në mënyrë që i akuzuari të ketë mundësi ta përgatis mbrojtjen e tij. Ky afat mund të shkurtrohet me kërkesën e të akuzuarit apo edhe të prokurorit të shtetit, me kusht që i akuzuari të ketë dhënë pëlqimin e tij.

Ky kod parasheh që përmes thirrjes të sigurohet prania e të pandehurit në procedurë, pra, ajo paraqet një urdhëresë me shkrim ndaj të cilës nuk mund të paraqitet ankesë dhe krijon obligim për të pandehurin që t'i përgjigjet thirrjes dhe atë në kohën e caktuar nga gjykata. Thirrja duhet të përmbajë ndër të tjera edhe njoftimin për pasojat në rast të moszbatimit të saj - njoftimin se ndaj të pandehurit do të lëshohet urdhërarrest dhe do të sillet forcërisht në gjykatë. Ndërsa në rastet kur i pandehuri nuk është në gjendje t'i përgjigjet thirrjes për shkak të sëmundjes ose pengesës tjetër të paevitueshme, ai pyetet në vendin ku gjendet ose dërgohet në ndërtesën e gjykatës apo në vendin tjetër ku është duke u zbatuar procedura ose shtyhet marrja e tij në pyetje.¹¹

Kjo nënkupton se obligimi për t'iu përgjigjur thirrjes nuk është absolut, sepse i pandehuri mund të jetë i penguar me arsye që t'i përgjigjet thirrjes, siç është sëmundja apo pengesa tjetër e paevitueshme. Edhe pse Kodi nuk e përcakton se çka mund të konsiderohet si "pengesë e paevitueshme", në bazë të zhvillimit teorik dhe shkencor mund të konkludojmë se fjala është për sëmundjen e anëtarit të familjes, fatkeqësia elementare, ndërprerja e trafikut etj.¹²

Një risi të cilën e ka sjellë Kodi i Procedurës Penale i vitit 2022 është mundësia e thirrjes së palëve dhe pjesëmarrësve në procedurë përmes postës elektronike apo adresës tjetër të komunikimit elektronik. Pra edhe i pandehuri gjatë shqyrtimit fillestar mund të jap një adresë të tillë për komunikim me gjykatën dhe gjykata mund të dërgojë thirrjet për seancat e ardhshme përmes këtyre adresave dhe komunikimi do të konsiderohet i rregullt, sigurisht nëse janë zbatuar edhe dispozitat e tjera të Kodit sa i përket dërgimit të shkresave. Në këtë rast detyrimi i të pandehurit që ta njoftojë gjykatën për ndryshimin e adresës vlen edhe për ndryshimin e adresës së tij elektronike.

Thirrja të pandehurit si parim i dërgohet me postë, por dërgesa mund të bëhet edhe nëpërmjet organit kompetent komunal, zyrtarit të organit që ka marrë vendimin ose drejtpërdrejt përmes atij organi.¹³ Gjykata mund t'ia komunikojë thirrjet edhe gojarisht personit i cili gjendet në gjykatë, së bashku me udhëzimin për pasojat e mosparaqitjes së tij. Thirrja e bërë në këtë mënyrë shënohet në procesverbal, të cilin personi i thirrur e nënshkruan, përveç kur

¹¹ KPP (2022), neni 172, par. 7.

¹² Sahiti, Murati, Elshani, vep. e cit., f.465.

¹³ KPP (2023), neni 474, par. 1.

kjo thirrje është shënuar në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor. Kjo mënyrë konsiderohet si dërgesë e rregullt.¹⁴

Gjykata gjithashtu mund të urdhërojë policinë e Kosovës që të bëjë dërgimin e shkresave nëse në rastet kur ka provuar gjykata në përpjekjen e parë që të komunikojë në format e lartcekura ka rezultuar se komunikimi ka qenë i pasuksesshëm ose nuk është e qartë nëse komunikimi është realizuar apo jo. Gjykata gjithashtu ka të drejtë që të urdhërojë Policinë e Kosovës që të dërgojë thirrjen edhe nëse nuk ka provuar mënyrat e lartcekura, nëse vlerëson se personi nuk do të veprojë në pajtim me thirrjen.

Në parim, thirrja për në seancën fillestare do t'i dorëzohet personalisht të pandehurit, por në rastet kur i njëjti nuk gjendet në adresën ku duhet të bëhet dorëzimi, atëherë dërguesi do të mësojë se kur dhe ku mund të gjendet i pandehuri dhe të njoftim me shkrim tek anëtari i rritur i familjes, kujdestari i banesës, fqinji ose tek personi që pranon postën në vendin e tij të punës, në mënyrë që të njoftohet i pandehuri për datën dhe orën se kur duhet të gjendet në banesën e tij për të pranuar thirrjen.

Ndërsa përveç dorëzimit personal, ligji parasheh edhe alternativat e dorëzimit personal për shkresat që nuk është e nevojshme të pranohen personalisht nga i pandehuri, siç është edhe thirrja për në shqyrtim gjyqësor. Në kuadër të këtyre mënyrave parashihet mundësia e pranimi të thirrjes nga ana e personit të rritur të familjes së të pandehurit apo edhe nga kujdestari i banesës ose fqinji, në qoftë se të njëjtit pajtohen ta pranojnë atë. Dërgimi i tillë mund të bëhet edhe në vendin e punës së të pandehurit dhe në mungesë të tij thirrja do të pranohet nga personi kompetent për pranimin e postës në vendin e punës apo nga personi i punësuar në të njëjtin vend pune, nëqoftëse ai pajtohet ta pranojë shkresën.

Nëse as këto mënyra të dorëzimit të thirrjes nuk mund të realizohen, atëherë të pandehurit do t'i lihet njoftimi se ku dhe deri në çfarë afati do të mund ta pranojë thirrjen për pjesëmarrje në shqyrtim gjyqësor, por nëse brenda këtij afati i pandehuri nuk paraqitet për të pranuar thirrjen brenda afatit të caktuar, atëherë ajo do të kthehet.

Thirrja për në shqyrtim gjyqësor apo në shqyrtimet pasuese të shqyrtimit fillestar mund t'i dërgohet të pandehurit edhe në mënyrë elektronike dhe do të ekzistojë prezumimi se i pandehuri personalisht ka pranuar shkresën edhe nëse informacionet e dhëna të kontaktit mund të jenë të ndonjë llogarie të regjistruar nga ndonjë familjar i palës ose nga ndonjë person tjetër.¹⁵

Thirrjet apo shkresat e tjera të dorëzuara në mënyrë elektronike konsiderohet se janë dorëzuar në kohën e dërgimit, përveç nëse marrësi provon se thirrja nuk është marrë apo është marrë në një datë të mëvonshme. Në rastet kur i pandehuri refuzon ta pranojë shkresën, e në rastin tonë thirrjen për

¹⁴ KPP (2023), neni 474, par. 2.

¹⁵ KPP, neni 475, par. 2.

seancë, dërguesi shënon ditën, orën dhe shkaku e refuzimit të marrjes dhe shkresën do ta lë në adresën e marrësit apo në vendin e tij të punës dhe dorëzimi i tillë do të konsiderohet i rregullt.

Në rastet kur i akuzuarit nuk paraqitet në shqyrtim gjyqësor dhe nuk e arsyeton mungesën, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues lëshon urdhërarrest. Në rastet kur i akuzuari nuk mund të sillet menjëherë para gjykatës, gjyqtari i vetëm gjykues apo trupi gjykues e shtyen shqyrtimin gjyqësor dhe urdhëron që i akuzuari në seancën e ardhshme të sillet me forcë ose në të kundërtën nxjerr aktvendim për pezullimin e procedurës penale, derisa i akuzuari të sillet në gjykatë.¹⁶

Në rastet kur pas lëshimit të urdhërarrestit i akuzuari e arsyeton mungesën e tij para se të arrestohet, gjyqtari i çështjes revokon urdhërarrestin. Në rastet kur i akuzuari i thirrur në mënyrë të rregullt qartazi po i shmanget procedurës duke mos marrë pjesë në shqyrtim gjyqësor e nuk ekzistojnë shkaqe për paraburgosjen e tij, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues mund të caktojë paraburgim për sigurimin e pranisë së të akuzuarit në shqyrtimin gjyqësor. Ky paraburgim mund të zgjasë deri në shpalljen e aktgjykimit e në asnjë rast më tepër se një muaj. Ndaj aktvendimit me të cilin caktohet paraburgimi është e lejuar ankesa, por kjo ankesë nuk do të pezullojë ekzekutimin e këtij aktvendimi.

6. Gjykimi në mungesë - kushtet për zbatimin e tij

Për zbatimin dhe rrjedhën e procedurës siç duhet, gjykata duhet ta ftojë përmes thirrjes të pandehurin dhe i pandehuri duhet të marrë pjesë në seancën e shqyrtimit fillestar dhe shqyrtimit kryesor.¹⁷ Në këtë rast, kur ligjdhënësi përmend shqyrtimin “kryesor”, mund të konkludojmë se fjala është për seancën e shqyrtimit “gjyqësor”, sepse siç e përcakton edhe pjesa tjetër e Kodit, kjo seancë paraqet pikën kulminante të zhvillimit të procedurës, duke qenë se këtu i jepet mundësia palëve në procedurë që të paraqesin argumentet e tyre, të paraqesin provat dhe faktet që u shkojnë në favor, të deklarohen dhe të pyeten dëshmitarët dhe të dëgjohen ekspertët. Por si duket ligjdhënësi pjesëmarrjen e të pandehurit në seancën e shqyrtimit gjyqësor e ka paraparë si një të drejtë të tij nga e cila i pandehuri mund të heq dorë.

Sipas nenit 303, paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Penale, do të konsiderohet se i akuzuari ka hequr dorë nga e drejta për të qenë i pranishëm në shqyrtim gjyqësor nëse i akuzuari ka qenë i pranishëm në seancë fillestare dhe është informuar për datën e shqyrtimit gjyqësor nga gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues në pajtim me nenin 280 dhe nenin 282 të këtij Kodi, apo gjatë ndonjë seance tjetër gjyqësore dhe i akuzuari është njoftuar

¹⁶ KPP, neni 302, par. 1.

¹⁷ KPP, neni 303, par. 1.

për detyrimin për të qenë i pranishëm për gjykim dhe se gjykimi mund të vazhdojë nëse i akuzuari vullnetarisht nuk paraqitet për gjykim, ose kur ka qenë i pranishëm në gjykim, por më pas nuk është paraqitur në seancat gjyqësore pasuese dhe është informuar për datën e re të shqyrtimit kryesor.¹⁸

Element crucial për t'u konsideruar se i pandehuri heq dorë nga e drejta për të qenë pjesë e shqyrtimit gjyqësor konsiderohet vullneti i tij, pra, kur i njëjti në mënyrë të qëllimshme, edhe pse ka qenë i informuar në pajtim me Kodin për datën dhe orën e seancës së shqyrtimit gjyqësor ose për datën dhe orën e vazhdimin të shqyrtimit gjyqësor, zgjedhë të mos marrë pjesë në seancën e shqyrtimit gjyqësor.

Në nenin 303 paragrafi 4 të Kodit është paraparë se për të vendosur nëse do të mbajë gjykimin në mungesë të të akuzuarit, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mban seancë dëgjimore për të përcaktuar përse i akuzuari mungon dhe për të vlerësuar çdo sqarim apo dëshmi nëse i akuzuari ka vendosur vullnetarisht të mungojë në gjykim. Në veçanti, në marrjen e këtij vendimi, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues merr parasysh nëse janë bërë përpjekje të arsyeshme për të gjetur të akuzuarin.¹⁹

Fakti se gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues duhet të mbajë seancë të veçantë dëgjimore, në të cilën do të vlerësojë nëse i akuzuari vullnetarisht mungon në seancë, paraqet një siguri të madhe procedurale për të pandehurit, sepse nuk vendoset të zhvillohet procedura në mungesë të tij pa u dëgjuar palët dhe argumentet e tyre.

Duke qenë se është fjala për mbajtjen e një seance dëgjimore të cilën e mban gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, është mangësi e këtij Kodi se nuk ka paraparë se kush konkretisht duhet të marrë pjesë në këtë seancë apo veçoritë e tjera që duhet ta shoqërojnë. Nga zhvillimi teorik i procedurës penale si shkencë, paralelisht me legjislacionin procedural penal të shteteve të tjera me rregullim të ngjashëm juridik si Kosova si dhe në frymën e legjislacionit tonë, mund të konkludojmë se në këtë seancë pritet të marrë pjesë prokurori i shtetit dhe mbrojtësi i të akuzuarit.

Mangësi tjetër mund të konsiderojmë edhe faktin se ky Kod nuk zgjidh rastet kur prokurori i shtetit nuk merr pjesë në këtë seancë apo kur mungon mbrojtësi i të akuzuarit dhe mbetet e paqartë nëse kjo seancë do të shtyhet apo mund të mbahet edhe pa prezencën e prokurorit të shtetit apo mbrojtësit të të akuzuarit. Nuk do të ishte e arsyeshme që të parashihej mbajtja e një seance të tillë nëse do të mund të mbahej pa prezencën e këtyre dy pjesëmarrësve kyç të procedurës, mirëpo mbetet të shihet në të ardhmen se si kjo çështje do të zgjidhet nga praktika gjyqësore.

Në seancën dëgjimore duhet të vlerësohet nëse janë bërë përpjekje të arsyeshme për të gjetur të akuzuarin, kjo duhet të përfshijë përpjekjen për t'i

¹⁸ KPP, neni 303, par. 2, pika 1 dhe 2.

¹⁹ KPP, neni 303, par. 4.

dorëzuar thirrjen në adresën e tij ose në vendin e punës ose në një nga mënyrat alternative të dërgimit personal apo edhe në formë elektronike, e si mundësi e fundit është përdorur edhe gjetja e të pandehurit përmes Policisë së Kosovës me anë të urdhërarrestit.

Nëse gjykata në seancën dëgjimore vlerëson se i pandehuri mungon vullnetarisht në gjykim, ajo, për të vendosur nëse do të mbajë gjykimin në mungesë të të akuzuarit, gjithashtu shqyrton nëse përmbushet ndonjë prej kushteve të mëposhtme:

a) vështirësinë e shtyrjes së gjykimit, veçanërisht në gjykimet që përfshijnë shumë të akuzuar;

b) barrën mbi prokurorin e shtetit për vijimin e dy gjykimeve që përfshijnë dëshmi të përbashkëta të të bashkëpandehurve; dhe

c) nëse vonesa do t'i vë dëshmitarët e prokurorisë në rrezik ose vështirësi të konsiderueshme.²⁰

Këto kërkesa, edhe pse emërtohen si kushte, si duket ligjdhënësi i ka paraparë në mënyrë opsionale, krahas vullnetit të të akuzuarit për të munguar - si kusht i domosdoshëm që të zhvillohet gjykimi në mungesë, për të fuqizuar nevojën që gjykimi të mos shtyhet më tutje dhe të mbahet në mungesë të të pandehurit.

Kushti i parë është mjaft i arsyeshëm, duke llogaritur vështirësitë për të siguruar praninë e të gjithë të akuzuarve në rastet kur janë disa prej tyre dhe shtyrja e seancës do të shkaktonte vonesa të panevojshme, të cilat do të mund të rezultojnë dhe me parashkrimin e çështjes.

Kushti i dytë ndërlidhet po ashtu me efikasitetin e procedurës dhe kësaj radhe merret në konsideratë ngarkesa e prokurorit të shtetit në rastet kur duhet të marrë pjesë në dy gjykime që përfshijnë dëshmi të përbashkëta të të bashkëpandehurve.

Kushti i tretë tejkalon suazat e efikasitetit të procedurës dhe ka të bëjë më tepër me sigurinë e dëshmitarëve, më konkretisht me sigurinë e dëshmitarëve të prokurorisë. Kjo situatë ka të bëjë me të akuzuarit e rrezikshëm, të cilët mund të ndikojnë, kanosin apo kërcënojnë në mënyra të ndryshme dëshmitarët e prokurorisë. Për të shmangur këto situata, duke pasur parasysh rëndësinë e dëshmive të dëshmitarëve si prova dhe duke u kujdesur për sigurinë e tyre për të inkurajuar shprehjen e tyre të lirë dhe të pandikuar, ky kusht është paraparë nga ligjdhënësi që të forcohet bindja e gjyqtarit të vetëm gjykues apo trupit gjykues që më tutje të procedohet në mungesë të të pandehurit. Konsiderojmë se termi “vështirësi e konsiderueshme” duhet të kuptohet edhe në aspekt të moshës së shtyrë, ngarkesës psikologjike që mund të paraqesë dhënia e dëshmisë, sidomos kur i dëmtuari paraqitet si dëshmitar dhe kjo në frymë të qëllimit se përse është paraparë gjykimi në mungesë në Kosovë.

²⁰ KPP, neni 303, par. 5, pika 1, 2 dhe 3.

Kur konsiderohet se i pandehuri ka hequr dorë nga e drejta për të qenë i pranishëm në shqyrtim gjyqësor dhe gjykimi është mbajtur, gjykata do të bëjë përpjekje të arsyeshme për ta njoftuar të pandehurin me aktgjykimin e marrë. Mirëpo, nëse i pandehuri sërish nuk mund të gjendet, atëherë, në emër të tij dhe duke marrë parasysh interesin më të mirë të të pandehurit, mbrojtësi i tij mund të parashtojë ankesë ndaj aktgjykimit në emër të të pandehurit. Ndaj aktgjykimit, mbrojtësi mund të parashtojë ankesë për njërin nga bazat:

a) për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale;
b) për shkak të shkeljes së ligjit penal;
c) për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike; ose

ç) për shkak të vendimit lidhur me sanksionet penale, konfiskimit, shpenzimeve të procedurës penale, kërkesave pasurore juridike, si dhe për shkak të vendimit mbi publikimin e aktgjykimit.²¹

Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesë mbrojtësi brenda afatit 30 ditor, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit dhe po ashtu i njëjti ka mundësi ta tërheq ankesën para se Gjykata e Apelit të jap vendimin e saj lidhur me ankesën, ndërsa tërheqja e ankesës nuk mund të revokohet. Edhe në rast të gjykimit në mungesë, ankesa ndaj aktgjykimit e pezullon ekzekutimin e aktgjykimit.

Edhe pse paraqitja e ankesës, është një e drejtë tejet e rëndësishme për të pandehurin, ligjdhënësi ka paraparë mundësinë që ajo të paraqitet edhe nga personat e tjerë, në këtë rast nga mbrojtësi si një person me njohuri profesionale dhe që vepron në interesin më të mirë të të pandehurit, mirëpo ligjdhënësi si duket ka pasur parasysh pikërisht këta faktorë kur ka paraparë mundësinë që mbrojtësi të mund ta tërheq ankesën para se të vendos gjykata më e lartë. Mbrojtësi, duke vepruar në interesin më të mirë të të pandehurit, duhet të kalkulojë se ndonjëherë ankesa ndaj aktgjykimit nuk është e arsyeshme dhe e bazuar dhe se vendimi i marrë është i drejtë dhe i bazuar në ligj, andaj është paraparë edhe mundësia e tërheqjes së ankesës, e cila si pasojë bartë ndalimin që të parashtrohet ankesë e re edhe në kuadër të afatit ligjor.

Edhe në rastet e gjykimit në mungesë, ankesa ndaj aktgjykimit do ta pezullojë ekzekutimin e aktgjykimit, sepse këto aktgjykime, ndër të tjera, mund të përmbajnë edhe dënime të cilat mund të ekzekutohen aty për aty pa praninë e të pandehurit, siç është konfiskimi i sendeve apo vendimi mbi publikimin e aktgjykimit.

Një veçanti e këtij Kodi është se kur i pandehuri akuzohet për veprat penale të gjenocidit, krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit, vepra tjera penale të cilat sipas të drejtës ndërkombëtare nuk parashkruhen dhe veprën penale të vrasjes së rëndë, nuk është e nevojshme të plotësohen kriteret si

²¹ KPP, neni 383, par. 1.

prania e tij në seancën fillestare dhe informimi i tij në lidhje me datën e shqyrtimit gjyqësor apo prania e tij në gjykim, ndërsa në seancat pasuese nuk është i pranishëm dhe mungesa e tij vullnetare sipas vlerësimit nga gjyqtari i vetëm gjykues apo trupi gjykues në seancë dëgjimore. Po ashtu nuk merren parasysh as kushtet nga neni 303, paragrafi 5, mjafton që gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues bindet se janë bërë përpjekje të arsyeshme për ta njoftuar të akuzuarin për shqyrtimin gjyqësor dhe për ta siguruar praninë e tij.²²

Përpjekjet e arsyeshme përfshijnë procedurat sipas neneve 172 dhe 173 të këtij Kodi dhe një fushatë informative të plotë, duke e thirrur të akuzuarin të dorëzohet në juridiksionin e gjykatës. Po ashtu, ftesa së bashku me aktakuzën publikohen në ueb faqen e Prokurorit të Shtetit, gjykatës që zhvillon procedurën dhe në gazetën zyrtare, duke i bërë thirrje të të akuzuarit të dorëzohet. Njoftimet e tilla i bëjnë thirrje çdo personi që ka informacion relevant për vendndodhjen e të akuzuarit që t’ia komunikojë atë informacion policisë.²³

Pra, në rastet kur të pandehurit është provuar t’i dërgohet thirrja sipas nenit 172 dhe ndaj të njëjtit është lëshuar urdhërarresti, por pa ndonjë rezultat në gjetjen e tij, gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues mund të vazhdojë në zhvillimin e procedurës në mungesë të të pandehurit. Kjo nënkupton se nuk kërkohet që i pandehuri të ketë marrë pjesë as në shqyrtim fillestar e as në ndonjë seancë tjetër, nuk kërkohet një shqyrtim më i thellë lidhur me vullnetin e tij për të qenë i pranishëm në seancë, por përmbushja e dy kushteve:

a) kushti subjektiv - mosprania e tij fizike dhe

b) kushti objektiv - i pandehuri akuzohet për vepër të paraparë si në nenin 104 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Në kuadër të përpjekjeve të arsyeshme për të siguruar praninë e të pandehurit është paraparë edhe publikimi në faqen e Prokurorit të Shtetit dhe në gazetën zyrtare, thirrja të pandehurit që t’i dorëzohet juridiksionit të gjykatës. Kjo është paraparë me qëllim që të pandehurit t’i ofrohet edhe një mundësi për të qenë i pranishëm në gjykimin e tij dhe të ushtrojë personalisht të drejtat të cilat i takojnë në procedurë dhe të parashtojë mbrojtjen e tij, e po ashtu duke qenë se ftesa dhe aktakuza publikohen në internet, të pandehurit i ofrohet mundësia që të njoftohet me procedurën ndaj tij edhe në rastet kur i njëjti deri në atë kohë nuk ka qenë i informuar.

Njoftimi publik lidhur me zhvillimin e procedurës - ftesa dhe aktakuza, të cilat publikohen në internet, mund të shërbejnë edhe në mënyrë të tillë që ndaj të pandehurit që fshihet, personat e tjerë të kenë mundësi që ta njoftojnë policinë lidhur me vendndodhjen e tij dhe në këtë mënyrë të shmanget edhe zbatimi i procedurës në mungesë të të pandehurit.

²² KPP, neni 303, par. 7.

²³ KPP, neni 303, par. 8.

Gjatë kësaj procedure i akuzuari duhet të përfaqësohet gjatë gjithë kohës nga mbrojtësi i cili caktohet nga radha e avokatëve të Odës së Avokatëve dhe i njëjti do të marrë pjesë në procedurë derisa aktgjykimi të marrë formën e prerë, pra i njëjti do të ketë mundësinë që në emër të të pandehurit të ushtrojë edhe ankesë.

Kodi ynë penal i ka ofruar të pandehurit, i cili gjykohet në mungesë për shkak të veprave penale të gjenocidit, krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit, veprat e tjera penale të cilat sipas të drejtës ndërkombëtare nuk parashkruhen dhe për vrasjen e rëndë, mundësinë që në çdo rast, sipas kërkesës së tyre, të kenë të drejtë në rigjykim të pakushtëzuar, automatik e të plotë.

Kjo është paraparë me qëllim që të ruhen të drejtat e të pandehurit ndaj të cilit është marrë një vendim, për shkak se i njëjti është gjykuar për vepra tejet të rënda dhe në këtë mënyrë një rigjykim, ndaj të cilit nuk kërkohet realizimi i ndonjë kushti të veçantë, i ofron personit të gjykuar një pozitë shumë të mirë në procedurë, sepse do të ketë mundësi që përmes një kërkesë të thjeshtë ta kthejë procedurën në pikën fillestare.

Ligjdhënësi si duket këtu ka pasur parasysh veçanërisht natyrën e veprave penale, prandaj personit të gjykuar në mungesë i ka ofruar një mundësi kaq të rëndësishme, e cila mund të aktivizohet në mënyrë tejet të thjeshtë dhe të pakufizuar në kohë.

7. Mbrojtja e detyruar në gjykimet në mungesë

Prania e mbrojtësit në procedurë penale siguron barazinë në procedurë, duke pasur parasysh se i pandehuri si person laik dhe person i cili gjendet në një pozitë të veçantë emocionale jo çdoherë mund të paraqesë mbrojtjen e tij si duhet, prandaj prania e mbrojtësit është tejet e rëndësishme, duke qenë se i njëjti është person me njohuri profesionale dhe i distancuar në aspektin emocional në lidhje me procedurën penale, gjë që i mundëson të paraqesë mbrojtjen siç duhet, në përputhje me ligjin.

Kodi ynë i procedurës penale ka paraparë në nenin 56 rastet kur mbrojtja është e detyruar, ndërsa në paragrafin 1, pika 6, është paraparë se mbrojtja është e detyruar në të gjitha rastet kur i akuzuari gjykohet në mungesë sipas nenit 303 të këtij Kodi.²⁴ I pandehuri mund të angazhojë vet mbrojtësin ose në emër të tij këtë mund ta bëjnë përfaqësuesi i tij ligjor, bashkëshorti apo bashkëshorti jashtëmartesor, personi i gjinisë së gjakut në vijë të drejtë, prindi adoptues, fëmija i adoptuar, vëllai, motra dhe prindi birësues. Por, në rastet e mbrojtjes së detyruar, nëse as i pandehuri dhe as personat e lartcekur nuk angazhojnë një mbrojtës, kjo barrë bie mbi gjykatën - konkretisht mbi gjyqtarin kompetent, i cili zbaton procedurën që të pandehurit t'i caktohet mbrojtës sipas detyrës zyrtare me shpenzime publike.

²⁴ KPP, neni 56, par. 1, pika 6.

Edhe në rastet e mbrojtjes së detyruar mund të hiqet dorë nga mbrojtja, por sigurisht se për të hequr dorë nga mbrojtja e detyruar kërkohet heqja dorë me shkrim dhe e nënshkruar nga i pandehuri dhe nga organi kompetent që zbaton procedurën ose përmes videokasetës, autenticitetin e së cilës duhet ta verifikojë gjykata, pasi është njoftuar me të gjitha të drejtat e tij në mbrojtje.

Megjithatë, pa qenë i pranishëm personalisht, i akuzuari nuk mund të marrë pjesë aktive në seancë dhe të ushtrojë të drejtat e tij të mbrojtjes. Prandaj gjykimet në mungesë kanë ngritur shqetësime serioze për të drejtat e njeriut dhe ekstradimi me qëllim të ekzekutimit të një dënimi që rezulton nga procedurat në mungesë mund të refuzohet sepse procedura të tilla nuk përmbushin të drejtat minimale të mbrojtjes.²⁵

Conclusion

Trial in absentia represents a form of implementing criminal proceedings in the absence of the key party to this procedure - the defendant, a procedure that has been frequently implemented in the past and even today in various countries and even in those countries where modern principles of criminal procedure do not prevail, this type of trial is used as a means of abuse of power and arbitrariness of judicial institutions.

Trial in absentia enables the administration of justice in any case, that is, even in cases where the defendant is absent without reason and evades justice, this leads us to a result in terms of the efficiency of the criminal procedure and also meets the support of a very relevant participant in modern criminal proceedings - the injured party, because the same is offered assurance by state institutions that a trial will be held even if the defendant does not participate in the trial.

Although trial in absentia enables these benefits, it is often opposed because it strikes one of the most important principles of justice - the right of the defendant to be present at his trial. Although in our time, as we have noted, criminal procedure legislation has provided for many conditions and security for the defendant against whom the process in absentia is applied, as is noted, this is not enough since no procedural guarantee replaces the presence of the defendant to carry out his defense, the presentation of the evidence he chooses, his statement and all the procedural actions that he may take during the procedure. Therefore, given that the presence of the defendant constitutes an irreplaceable difference in criminal proceedings, the trial in absentia is often seen by the general public as arbitrary, unethical and a violation of the rights of the defendant. Given that this trial has now been implemented in Kosovo, we note that one of the greatest guarantees that are given to the defendant for

²⁵ Böse M, European arrest warrants and minimum standards for trials in absentia - blind trust vs. transnational direct effect, Bon, 2021, f.276.

a fair trial is the presence of the defense attorney. Of course, the participation of a specialized person who knows the procedure implies greater security in cases of trial in absentia and the presence of the same person balances the courtroom, resulting in the realization of equality of the parties in the procedure.

Another guarantee is the case when the person convicted in absentia (for criminal offenses as provided for in Article 104 of the Criminal Code of Kosovo) is enabled to automatically and fully have the right to a retrial upon his request, without any limitation in terms of time for submitting the request or his right to present new evidence or any other procedural action.

While Kosovo, with the changes in its legislation, claims to try war crimes, which for a long time have remained untried precisely due to the lack of presence of the defendants, on the other hand, no concrete case of the implementation of trial in absentia for any other criminal offense has been encountered until the time this paper was compiled. This apparently has to do with the fact that the Criminal Procedure Code has foreseen the fulfillment of many conditions to arrive at the possibility of implementing trial in absentia, so that by then the presence of the defendant is enabled.

Given that Kosovo has not long ago foreseen trial in absentia, it has not yet faced the problems that will arise with its practical implementation, therefore it will have the best chances if it follows the practice of other states that have gone through similar problems in order to pass the period of major legislative changes as easily as possible.

Recensentë:

Prof. dr. Hajredin Kuçi

Prof. dr. Sadik Haxhiu

Bibliografia:

- Böse M, European arrest warrants and minimum standards for trials in absentia - blind trust vs. transnational direct effect, Bon, 2021.
- Sahiti E, E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 1988.
- Sahiti E, Murati R, dhe Elshani Xh, Kodi i Procedurës Penale i Kosovës - Komentar, Botimi I, Prishtinë, 2014.
- Ligji i procedurës penale i RSFJ, 1977.
- Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale, UNMIK/RREG/2003/26, 6 prill 2004.
- Kodi i procedurës penale, Nr. 04/L-123, 1 janar 2013.
- Kodi i Procedurës Penale, Nr. 08/L-032, 17 shkurt 2023.
- Rregullore e UNMIK, nr. 2000/5927, tetor 2000.